



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	03.07.2026
Referencë	11-344/6
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-Qershor

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit qershor Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara sipas planifikimeve dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë shqyrtuar ankesat e pranuar nga qytetaret, ankesat ishin në fshatrat Gadime e Ulët, Vërshevc, Lipjan, ankesat kryesisht ishin për vendosje të plehut të stallës afër shtëpisë së banimi, ndotje me ujëra të zeza, pastaj me vendosje të mjeteve të punës dhe materialit në hapësirën publike. Për rastet në fjalë janë dhënë urdhëresa që të sanohen parregullsitë e konstatuara brenda një afati të caktuar, në të kundërtën do të pasojnë masat ligjore.

Sipas ankesave të shumta nga qytetarët, se nuk po merren mbeturinat sipas orareve të caktuar nga KRM Pastrimi dhe se po ka shume vonesa, kemi dalë në kontroll në disa fshatra dhe në qytet, për të verifikuar gjendjen. Për gjendjen në teren rreth menaxhimit të mbeturinave është bërë raport, dhe ju është dërguar Kryetarit të Komunës.

Janë bërë inspektime në deponit ilegale të mbeturinave në f.sh Kraishtë, Kodrën Kërçevës, dhe Torinë, Në fshatin Torinë në deponin ilegale e cila është pastruar nga Komuna, janë hedhur mbeturina përsëri dhe në bazë të dëshmive të gjetura është identifikuar personi, ndaj të cilit janë marrë të gjitha veprimet ligjore, si dhe largimin e mbeturinave nga vendi i hedhjes. Pas rikontrollës u pa se urdhëresa është zbatuar. Janë inspektuar objektet në ndërtimi e sipër në qytet, në lidhje me zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore Komunale. Investitorët janë urdhëruar që në vendpunishte të grumbullohen mbeturinat dhe ato ti dorëzohen KRM Pastrimi.

Inspektorët e trafikut- Gjatë këtij muaji janë zhvilluar aktivitetet të vazhdueshme inspektuese në sektorin e Komunikacionit.

Janë realizuar kontrolla ndaj operatorëve të transportit me autobus për rendet e udhëtimit, me që rast janë verifikuar pikat e ndalimit si dhe funksionimi i operatorëve që ushtrojnë veprimtarin në territorin e Komunës së Lipjanit.

Gjithashtu janë zhvilluar inspektime ndaj radio-taksive dhe auto-taksive të cilët ushtrojnë veprimtari ilegale në Aeroportin Ndërkombëtar “ Adem Jashari” janë kontrolluar edhe auto-taksit legal të cilët janë të licencuar dhe kanë të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë taksi.

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi, janë realizuar inspektime në rrugët e qytetit për verifikimin nëse auto-taksit janë të pajisur me licenc valide për ushtrimin e veprimtarisë, të lëshuar nga organet kompetente.

Në vazhdimësi, gjatë ditëve të hëna, janë zhvilluar kontrolla në tregjet e qytetit, përfshirë tregun e kafshëve, mobileve dhe të gjelbërt.

Inspektori i ndërtimit- gjatë muajit qershor janë inspektuar objektet e ndryshme ndërtimore në qytetin e Lipjanit si dhe përgjatë zonave industriale ekonomike dhe në qytet. Gjatë inspektimeve në terren inspektori i ka evidentuar dhe konstatuar me procesverbal ndërtimet të cilat janë duke u ndërtuar me Leje ndërtimore si dhe ato pa Leje ndërtimi. Ndaj ndërtimeve pa leje janë ndërmarrë masa ligjore, duke vendosur edhe shirita zyrtar.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjës në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në formë të shkruar, elektronike.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit qershor janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët																				
Gjithsej inspekte																				
Inspekte me procesverbal																				
Objekte të legalizuara																				
Fletëparaqitje																				
Njoftime nga DPMUMM-ja																				
Njoftime																				
Vërejtje																				
Pranim teknik me komision (projekte komunale)																				
Vendosje të shiritave																				
Inspekte me miratim																				
Punë me palë, ankesa , kërkesa																				
Lendet e pranuara																				
Lende të pezulluara, ekzekutuara gjyqësore																				
Inspekte në ANP																				
Gjoba mandatore																				
Njoftim për fillimin e ndërtimeve																				
Leje ndërtimore																				
Menaxhim i tregjeve																				
Aktvendime, ndalesa, urdhëresa																				
Inspekte për leje Mjedisore Komunale																				
Inspektim me polici																				
Inspekte të përbashkëta																				
Ambienti	30	10				2				5	9							3	1	
Ndërtimi	62	18	1			7		3		5	19			3	3	2		1		
Trafiku	98	8					34		19		1	21					9		2	4
Gjithsej	190	36	1			9	34	3	19	10	29	21		3	3	2	9	1	3	4

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet kryesisht janë mbajtur me qytetarë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.